



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2019:212446

Datë: 15.02.2021

Numri i dokumentit: 01507114

**C.nr.317/2015**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Gazmend Ajvazi dhe me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen kontestimore të paditësit-kundër të paditurit N.T.P “G.”, të cilin e përfaqëson Mustafë Musa avokat nga Gjilani ndaj të paditurit-kundër paditësit D. H, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Afrim Salihu avokat nga Gjilani, me objekt të kontestit pagim i borxhit pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik me dt. 03.02.2021, me daten 15.02.2021 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit-kundër të paditurit N.T.P “G.” – Komuna e Vitisë dhe **DETYROHET** i padituri – kundërpaditësi D. H që paditësit t’ia kompensojë shumën e të hollave prej 22,003.50 € në emër të borxhit, me kamatë ligjore ashtu sic paguajnë bankat për mjetet e deponuara pa destinim të vecantë, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**II. REFUZHET** si e pabazuar kundërpadia e të paditurit D. H – Komuna e Vitisë me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jomaterial në shumë të përgjithshme prej 44,449.00 €, si pasojë e pranimin të betonit në cilësinë e dobët.

**III. OBLIGOHET** i padituri – kundërpaditësi D. H – Komuna e Vitisë, që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore, paditësit – kundër të paditurit N.T.P “G.”, t’ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 1,014 €, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimin të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Fillimisht paditësi përmes përfaqësuesit të tij me autorizim si në shkresat e lëndës me dt. 12.12.2012, ka paraqitur padi ndaj të paditurit I. Y, me objekt kontesti pagim borxhi, ku ka theksuar se paditësi ka furnizuar vazhdimisht me sasi të betonit të paditurin, dhe vazhdimisht për cdo sasi e betonit është dërguar edhe fletëdërgesa nga firma e paditësit ku dëshmohet se pranim-dorëzimi i mallit është kryer. Paditësi thekson se i padituri i ka paguar vetëm 2000 €, për cka ka mbetur borxh edhe 22.449.00 €, dhe e ka vështirësuar punën duke mos paguar detyrimin që ka ndaj paditësit, edhe pse paditësi ka kërkuar që disa herë rradhazi që të paguhen këto obligime, mirëpo i padituri nuk i ka përfillur kërkesat e paditësit dhe e ka ndërprerë punën duke vazhduar punimet me një firm tjetër. I njëjti me parashtrësën e dt.28.07.2016 ka precizuar

kërkesëpadinë në aspektin subjektiv, ku kanë kërkuar që procedura të vazhdohet me personin D. H- Komuna e Vitisë

I padituri me dt.22.02.2012 ka paraqitur përgjigje në padi me të cilën ka theksuar se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit lidhur me bazën e kontestit dhe se potencon se paditësi në vitin 2011 ka paguar shumën në vlerë prej 22.000 € për 367 m<sup>3</sup> beton dhe në vitin 2012 ka paguar shumën në vlerë prej 24,449 €, përafërsisht prej 400 m<sup>3</sup> beton, ku të njejtit janë dakorduar që betoni të jetë i cilësisë MB30, e cila është një ndër cilësitë më të mira lidhur me ndërtimin e lartë, por ky beton i kontraktuar pas një kohe ka filluar që të rëpiset apo të bie nga ngjitja kimike dhe nuk është në cilësinë e kontraktuar.

I padituri me dt.23.02.2012 ka paraqitur kundërpadi ndaj paditësit, me objekt të kontestit kompensimin e dëmit material lidhur me cilësinë e dobët të betonit, duke theksuar se paditësi ka furnizuar të paditurin me cilësi të betonit të dobët, dhe i padituri me rastin e këtij veprimi është dashur që t'a ndaloj ndërtimin e mëtutjeshëm të katit 2 dhe 3 për shkak të kualitetit të betonit, është dashur që podrumin t'a forcojë me 12 shtylla mbrojtëse si përforsim me qëllim që të mos shembet kati i parë dhe të mos e shfrytëzojë një pjesë të podrumit prej 285 m<sup>2</sup> për të cilin i njejtë kishtë bërë plane pas përfundimit t'a shfrytëzojë për qëllime objektive të tij dhe të biznesit. I njejtë në seancën e dt.23.11.2020 ka precizuar petitumin e kundërpadisë ku ka kërkuar nga i padituri N.T.P "G.", që të bëjë kompensimin e dëmit material si pasojë e dërgimit të betonit të cilësisë së dobët dhe të vërtetohet se betoni i cili është kontraktuar nuk është pranuar i cilësisë MB30, ashtu sic është bërë porosia, ku si pasojë e kësaj, pala e paditur-kundërpaditësi është detyruar që t'a forcojë pjesën e podrumit me shtylla të betonit ekstra me një beton krejt tjetër në një kompani tjetër të marrë me arsyetim që të forcohet podrumi.

I autorizuari i paditësit-kundër të paditurit në seancën e shqyrtimit përgatitor, kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetemi pranë padisë dhe kërkespadiës, dhe pranë thënieve nga seancat e kaluara, meqenëse nga provat e shtjelluara dhe faktet e vërtetuara, me padyshim vërtetohet themelsia e kërkespadiës. Ndërsa kanë kundërshtuar në terësi pretendimet e përgjegjies në padi dhe pretendimet e kundërkërkespadiës, me arsyetim se kundërkërkespadija nuk gjen mbështetje në provat dhe faktet nga shkresat e lëndës, me që detyrimi ka lindur në vitin 2011 dhe 2012, ndërsa kundërpadija është ushtruar ma 2 mars 2015, në pajtim të dispozitës së nenit 376 paragrafi 1 i ish-LMD-së, ka arritur parashkrimi i kërkesës sipas kundërpadiës nga fakti se dispozita e përmendur parashef afatin subjektiv prej 3 viteve. Andaj, meqë kundërpadija është ushtruar pas këtij afati, kjo kërkesë është e parashkruar, dhe si të tillë i kanë propozuar gjykatës që ta refuzoj në terësi sitë pabazuar edhe atë si për dëmin material dhe atë jomaterial, për më tepër mbetemi pranë fjalës përfundimtare të përgaditur me shkrim të cilën do ja dorëzojmë gjykatës e ku kemi të specifikuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore. Nga të cekurat i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj në terësi kërkesëpadinë e paditëses si të themeltë.

Përfaqësuesi i të paditurit-kundërpaditësi në seancën përgaditore , kryesore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në terësi pranë pretendimevet tona ndaj padisë dhe realizimin e të drejtës tonë me anë të kundërpadiës, gjithashtu mbetemi në terësi edhe ndaj përgjegjies në padi dhe precizimit të padisë të cilin e kemi bërë gjatë shqyrtimeve gjyqësore. Më tutje kanë deklaruar se pas disa seancave maratonike ndërvite u vërtetua saktë se pretendimi i paditësit ka të meta absolute sa i përket aspektit subjektiv sepse fillimisht është paditur I. Y e pasi që paditësi nuk ka mund ta vërtetoj personalitetin subjektiv i njejtë e ka ndryshuar padinë në aspektin subjektiv duke e filluar kontestin në emër të D. H, kjo bie ndesh në mënyrë absolute, sepse të gjitha fletdërgesat janë dorëzuar në emër të I.Y-t. Me anë të këtij

pretendimi kanë njoftuar gjykatën se këto prova materiale për ne janë absolutisht të papranueshme sepse janë në kundërshtim me LPK-në.

Me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike në këtë çështje kontestimore gjykata ka adminstruar këto prova: Fletëdergesat mbi dorëzimin e betonit të dt.08.06.2012, 08.05.2012, 17.05.05.2012, 17.05.2012, 24.03.2012, 17.05.2012, 24.03.2012, 09.06.2012, 01.06.2012, 20.03.2012, 06.06.2012, 23.07.2012, 20.03.2012, 07.04.2012, 29.06.2012, 22.05.2012, 30.06.2012, 12.06.2012, 07.04.2012, 11.05.2012, 11.05.2012 dhe e dt.22.05.2012; Raporti i lëshuar nga N.SH “”... i dt.15.10.2012; Ekzaminimi i betonit nga firma “D.– B. P.”... me seli në Prishtinë e dt.02.10.2012; Ekspertiza e ekspertit I. T... dhe Ekspertiza e ekspertit L. D... nga Prishtina si dhe ekspertiza plotësuese e të njejtit ekspert.

Eksperti financiar Mr.Sc.I. T.... në ekspertizën e dt.22.11.2017, ka theksuar se përcaktimi i cmimeve të shitjes së betonit MB 30 nga fletëdergesat e mallit të dërguar është vlerësuar në bazë të cmimeve të tregut të marra nga 3 biznese të tjera të cilat mirren me prodhimin e betonit në regjionin e Gjilanit, dhe në fund ka konstatuar se nga llogaritjet e përgjithshme të prezentuara në ekspertizën e lartëcekur rrjedh se shuma e borxhit të llogaritur është 22,003.50 €.

Eksperti L. D... nga Prishtina në ekspertizën e tij të dt.26.07.2020 ka konstatuar se klasa e betonit sipas deklaratës së palëve nuk ka arritur markën .. apo ..., pra duke i përdorur metodat bashkëkohore eksperti e lartëcekur ka ardhur në përfundim se klasa e prezentuar e betonit në fletëdergesa të paditësit prej MB30 (C30) është më e ulët pas matjeve të bëra në vend të ngjarjes por edhe nga disa ekzaminime nga laboratorët “I”... dhe “B. P”.... I njejtë është dëgjuar edhe në seancën e dt.23.11.2020 në të cilën ka theksuar se përqindjet e deklaruara nga ekspertiza e bërë në vendshikim kanë rezultuar se janë më të vogla se klasa MB30 (C30), pra rezultati është më i vogël se marka 30, gjithashtu i njejtë ka theksuar se pas 90 ditëve, nuk ka asnjë problem që klasa e betonit të dështojë me kohë dhe të jep rezultate tjera. I njejtë ekspert edhe në plotësimin e ekspertizës me dt.05.01.2021 ka ardhur në përfundim se klasa e betonit sipas deklaratës nuk ka arritur markën ... pra klasa e prezentuar e betonit në fletëderggesë të paditësit është më e ulët pas matjeve të cilat i ka bërë eksperti i lartëcekur.

Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si dhe në bazë të rezultatit të procedurës së zhvilluar kontestimore, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Nga Fletëdergesat mbi dorëzimin e betonit shihet se paditësi – kundër i padituri ka dorëzuar betonin për furnizim tek i padituri – kundërpaditësi, në sasi të ndryshme të betonit për m3.

Nga Raporti i lëshuar nga N.SH “I”... i dt.15.10.2012, gjykata vërtetoi faktin se shtylla 1 përmbëhet prej 19.1 N/mm<sup>2</sup>, pllaka e podrumit përmbëhet prej 30.2 N/mm<sup>2</sup>, pllaka e përdhesës përmbëhet prej 29.3 N/mm<sup>2</sup> dhe shtyllat e podrumit përmbëhen prej 25.7 N/mm<sup>2</sup>.

Nga Ekzaminimi i betonit nga firma “D. – B. P”... me seli në Prishtinë e dt.02.10.2012, gjykata vërtetoi faktin se në datën në fjalë, vjetërsia e betonit ka qenë 28 ditë dhe betoni në fjalë është përmbërë prej 25/30 Ckr.

Nga Ekspertiza e ekspertit I. T..., gjykata vërtetoi faktin se nga llogaritjet e përgjithshme të prezentuara në ekspertizën në fjalë rrjedh se shuma e borxhit të llogaritur është 22,003.50 €.

Nga Ekspertiza e ekspertit L. D...nga Prishtina si dhe ekspertiza plotësuese e të njëjtit ekspert, gjykata vërtetoi faktin se klasa e betonit në fletëdërgesa është më e ulët pas matjeve të bëra nga eksperti dmth është më e ulët se sa cilësia ...

Gjykata për marrjen e këtij vendimi, u bazua në Ligjin mbi marrëdhëniet e detyrimeve PR.Nr.690 i datës 30 mars 1978, pasi që detyrimi ka lindur në vitin 2011, në kohën kur ka qenë në fuqi ligji i lartëcekur, andaj gjykata u bazua në nenin 17 të LMD-së i cili shprehimisht parasheh se **“Pjesëmarrësit e marrëdhënies së detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij, përgjegjës për përmbushjen e tij.”**, në dispozitën e nenit 262 paragrafi i LMD-së, së vjetër janë parashikuar përmbushjet e detyrimit dhe pasojat e mospërmbushjes, gjegjësisht ky nen shprehimisht thotë se : **“Kreditori në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta mbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij .”** dhe në paragrafin 2 po të njëjtit ligj citohet: **“Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonon me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak.”**, e po ashtu në bazë të nenit 154 në të cilin citohet: **“Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij..”**, pra mbi bazën e lartëcekurave gjykata e aprovoi kërkesën e paditësit – kundër të paditurit për kompensimin e mallit të dorëzuar, dhe se në rastin konkret gjykata vërtetoi se ekziston përgjegjësia e të paditurit për mos-pagimin e borxhit edhe, pasi që i njëjti nuk i ka respektuar kushtet e kontratës dhe nuk ka marrë shpërblimin për mallin e dorëzuar sipas të njëjtës kontratë.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit duke refuzuar kundërpadinë e të paditurit bazuar në faktin se detyrimi është krijuar para dt 20.12.2012 dhe gjykata ka aplikuar Ligjin mbi marrëdhëniet e detyrimeve PR.Nr.690 i datës 30 mars 1978, pasi që pas dorëzimit të mallit-betonit, në vitin 2011 ka filluar të ndërtohet projekti, kurse kundërpaditësi ka paraqitur kundërpadinë me 23.02.2015 pra pas afatit të paraparë ligjor, ku ky afat përcaktohet në nenin 378 të LMD-së , i cili rregullon afatin e paraqitjes së kërkesës për shpërblimin e dëmit dhe i njëjti thekson se **“Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkakuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin”**, pra sa i përket kundërpadisë shihet se e njëjta në bazë të dispozitës të lartëcekur është parashkruar.

Gjykata lidhur me kërkesën për kamatë ka vendosur në mbështetje të neneve 277 dhe 1042 të LMD-së së vitit 1978, duke marr parasysh se ky raport juridiko-civil është krijuar para dt.20.12.2012 dhe në atë kohë ka qenë në fuqi ligji i lartëcekur.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi është marr në pajtim me nenin 452 paragrafi 4 të LPK-së, duke pasur parasysh faktin e suksesit në procedurë të paditësit, ashtu që të njëjtin e obligoi që të paditurit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumën e përgjithshme prej 1,014, edhe atë 104 € për përpilimin e padisë,për taksën gjyqësore shumën prej 100 €, për 6 seanca të mbajtura nga 135 € , në shumë të tërësishme 810 €, të gjitha në afat prej 15 ditë, pas ditës së pranimit të vendimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj, nga të lartëcekurat bazuar në bindjen e lirë në njërën anë dhe në nenin 17,262 dhe 378 të LMD-së, së vitit 1978 dhe nenin 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2019:212446  
Datë: 15.02.2021  
Numri i dokumentit: 01507114

**Gjyqtari,  
Gazmend Ajvazi**

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimet të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.